

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Objkti i Procedures:** “Vleresim i përgjithshëm mbi Sigurine Kibernetike dhe kryerjen e testimeve mbi Infrastruktura dhe Platformat Teknologjike”

- **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):  
98390000-3 - Shërbime të tjera**

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 106,833,333 (Njëqind e gjashtë milion e teteqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) leke pa TVSH ose 1,033,504 (Një milion e tridhjetë e tre mijë e pesëqind e kater) euro pa TVSH. **Referuar kursit të kembimit të B.SH date 18.12.2023 ku 1 euro = 103.37 All.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP SH.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur që kjo procedure të mos jete ne lote sipas arsyetimit të meposhtem:**

Ne zbatim të Paragrafit 2 Pika 1 e Nenit 39 të LPP, Njesia e Prokurimit sqaron se, nuk ka perzgjedhur ndarjen ne Lote te procedures se prokurimit per arsye se kjo procedure eshte e pamundur teknikisht te ndahet ne kontrata te ndryshme sepse nga vete objekti i prokurimit, konsiston ne vleresimin e sigurise kibernetike.

Për momentin OSHEE sh.a. ka në tërësi disa nga infrastrukturat më të rëndësishme dhe komplekse të IT-së në vend. Duke iu referuar rëndësisë që furnizimi me energji ka në jetën e sotme sociale-ekonomike, infrastruktura e OSHEE-së mund të konsiderohet jetike, me një ndikim të gjerë në jetën e përditshme të Shqipërisë. Në të kaluarën, sistemet e IT ishin të izoluar, ndërsa sfida e sotme është lidhja e disa sistemeve së bashku nëpërmjet shkëmbimit të vazhdueshëm të të dhënave të shumëfishta. Ky shkëmbim gjithnjë në rritje i të dhënave dhe faktorëve të tjerë, përbëjnë një rrezik të madh për infrastrukturën e OSHEE-së në aspektin e Sigurisë Kibernetike. Kërcënimi nga sulmet keqdashëse është i pashmangshëm, në qoftë se nuk ka kundërmasa të sakta dhe protokolle

të detajuar të mbrojtjes nga këto sulme. Në kontekstin e një peizazhi të kërcënimit kibernetik në zhvillim të shpejtë, OSHEE sh.a. është e vetëdijshme se realizimi i sigurisë kibernetike dhe zbutja e risqeve janë kritike për të mbështetur operacione të besueshme, në kohë, të sigurt dhe efikase. Shumë pajisje elektrike në të gjithë botën po rritin ndërlikimin dhe digjitalizimin e sistemeve të tyre, për të fituar efikasitet operacional dhe për të përmbushur kërkesat sfiduese të klientëve.

Qëllimi përfundimtar i këtij angazhimi është të demonstrojë transformimin e vërtetë të prioritetëve dhe aktiviteteve të sigurisë së OSHEE Group në një program të integruar sigurie. Gjithashtu, një nga objektivat kryesore të këtij angazhimi është vlerësimi dhe zhvillimi i një programi të detajuar të sigurisë për përmirësimin e aftësive të sigurisë kibernetike në OSHEE Group, në përputhje me legjislacionin në fuqi, praktikën e BE-së dhe kuadrin më të zakonshëm të sigurisë kibernetike. Për të arritur këtë qëllim, ne i shohim objektivat e mëposhtëm si elementë të rëndësishëm për projektin tonë:

- a) Përdorimi i një kuadri model në përputhje me standardet rregullatore ndërkombëtare për të vlerësuar pikat e forta dhe të dobëta të gjendjes aktuale të zhvillimit të programit tonë kibernetik në të gjithë stafin, proceset dhe fushat e teknologjisë. Ne duhet të identifikojmë dhe vlerësojmë dobësitë kryesore, rreziqet dhe ekspozimin e mundshëm ndaj kërcënimeve kibernetike në infrastrukturën tonë.
- b) Përcaktimi i një qëllimi të ardhshëm të sigurisë kibernetike, duke përfshirë identifikimin e çdo boshllëku midis gjendjes aktuale dhe asaj të ardhshme që duhet të adresohet.
- c) Hartimi i një liste me rekomandime të përshtatshme dhe të zbatueshme për përmirësimin e prioritetëve, të përbërë nga praktikën më të mira që adresojnë drejtpërdrejt mangësitë e identifikuar dhe ndihmojnë OSHEE Group-në të krijojë një plan për të arritur objektivin tonë të ardhshëm.
- d) Përcaktimi i një sistemi monitorimi të vazhdueshëm të pozicionit të sigurisë, duke zbatuar veprime për të ngritur nivelin e sigurisë në mënyrë që të përballen me veprime sulmi gjithnjë e më të sofistikuar.
- e) Liste kontrolli mbi përmbajtjen dhe plotësimin e dokumentacioneve të masave të sigurisë në përputhje me ISO 27001.

Ofruesi duhet të përgatisë një listë rekomandimesh për masat e sigurisë që mund të përdoren për të zbuluar paraprakisht dhe për të parandaluar sulmet kibernetike si:

- Firewalls ose pajisje të ngjashme harduerike për të parandaluar disa komunikime të përjashtuara nga rregullat e sigurisë dhe që monitorojnë trafikun e rrjetit për të identifikuar aksesin e paautorizuar.
- Sistemi i zbulimit të ndërhyrjeve ose aplikacioni i ngjashëm që zbulon aktivitetin e synimit të sulmit të mundshëm nga hostet me veçori të tilla si: modifikimi i skedarit (kontrolluesi i

integritetit të skedarit), profilet e thirrjeve të sistemit operativ, aksesit i paautorizuar ose funksionimi me qëllim të keq ose jonormal në një sistem ose rrjet kompjuterik.

- Trajnimi i vazhdueshëm i personelit të OSHEE Group për të minimizuar gabimet njerëzore në menaxhimin e përdorimit të e-mail dhe sistemeve të shfletimit në internet.
- etj.

**Per sa mesiper kjo procedure nuk mund te ndahet ne lote.**

## **I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40,000,000 (Dyzet milion) leke pa TVSH.

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qendrueshëm gjatë 3 (tre) viteve të fundit 2020, 2021, 2022. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit, të konfirmuara nga organet përkatëse. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pikat 1, 2, dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e shërbimit dhe vlerën e konsiderueshme të fondit limit të kësaj kontrate, kompleksitetin e produkteve dhe shërbimeve, sasinë dhe cilësinë e tyre, kërkohet

qe OE ofertues te vertetoje se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë ne kohe dhe ne përputhje me specifikimet teknike te kërkuara. Për këtë arsye, OE ofertues duhet te këtë disponibilitetin e duhur ekonomik ndaj është argumentuar se vlera mesatare e xhiros për tre apo me pak vitet e fundit financiare te jete ne masën 40,000,000 (Dyzet milion) leke pa TVSH, duke qendruar madje brenda normes prej 40% te vleres se fondit limit qe prokurohet, norme shume me e ulet se ajo qe percaktohet si limit i mundshem nga LPP 162/2020 date.

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 13 pika 2: *“Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi”*.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per shërbimet/produktet e mëparshme të ngjashme të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates në nje vlere jo më të vogël se 40,000,000 (Dyzet milion) leke pa TVSH.

- a) Për përvoja te mëparshme të realizuar me sektorin publik, autoriteti kontraktor kerkon si dëshmi vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më shumë se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatorëve ekonomik që ofrojnë këto lloje produkte/shërbimesh, pavarësisht rëndësise dhe kompleksitetit të produkteve / shërbimeve objekt procedure prokurimi, bazuar dhe në frymën e konkureshmerisë që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë / realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë rreth 40 % e vlerës (në vijimesi edhe me LLP të mëparshme) dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do të jetë realisht në gjendje të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK, e cila ka në funksionim një seri sistemesh të ndërlidhura dhe të informatizuara e teknologjise së lartë dhe me impakt shumë të madh financiar në rast bllokimi apo mos-funksionimi.

---

**2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombëtare me:**

- a. ISO 9001:2015 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme)
- b. ISO 27001:2022 ose ekuivalente për Sigurinë e Informacionit (e vlefshme)
- c. ISO/IEC 20000-1:2018 ose ekuivalente (për menaxhimin e shërbimeve të teknologjise së informacionit).

*Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.*

*Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrë përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Certifikimi **ISO 9001:2015** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë implementuese.

Certifikimi **ISO 27001:2022** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe e kanë një rëndësi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikepamja informatike dhe të jenë të kontrolluara dhe si dhe aksesimi mbi to të jetë i verifikueshëm e i kodifikuar). Kjo vjen pasi në këto kontrate do të ketë edhe përdorim të aplikacioneve të reja për diagnostikimin e elementeve të sigurisë së sistemeve ekzistuese që kërkojnë kompetencë të shtuar profesionale në këto drejtim. Ky certifikim kërkohet në përputhje me proporcionalitetin e vlerës së fondit limit të venë në dispozicion dhe bazuar në kompleksitetin dhe rëndësinë e funksionalitetit online të sistemeve aktuale që OSHEE Group shpesh ka në përdorim.

Certifikimi **ISO 20000-1:2018** shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qenë se zoteron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjisë së informacionit, duke pasur me shumë garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të gjithë sistemin në teresi i cili është teresisht i bazuar në produkte TIK (software dhe hardware). Ky certifikim kërkohet në përputhje me proporcionalitetin e vlerës së fondit limit të venë në dispozicion dhe bazuar në kompleksitetin dhe rëndësinë e funksionalitetit online të sistemeve aktuale që OSHEE Group shpesh ka në përdorim;

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të ketë të punësuar jo më pak se 10 punonjës gjithashtu duhet të provojë (me CV ose cdo dokument provues) se ka në stafin e tij personel kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj, me të paktën 1 (një) vit përvojë në sigurinë kibernetike për sistemet TIK njesoj apo të ngjashëm me sistemet e kësaj procedure. Ky staf kryesor duhet të jetë i kualifikuar dhe trajnuar mirë në fushën e inxhinierisë dhe sigurisë kibernetike, të cilët duhet të disponojnë të paktën certifikimet si më poshtë vijon:

a. *Te pakten 1 (një) specialist të certifikuar në GDPR dhe në mbrojtjen e informacionit sensitive ose ekuivalent;*

- b. *Te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar PMP “Project Manager” ose ekuivalent;*
- c. *Te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar Lead Auditor ISO 27001 “Information Security Management Systems”;*
- d. *Të paktën 1 (një) specialist i certifikuar CISM – Certified Information Security Manager ose ekuivalent;*
- e. *Te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar OSCP “Offensive Security Certified Professional” ose ekuivalent;*
- f. *Te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar CISSP “Certified Information Systems Security Professional” ose ekuivalent;*
- g. *Te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar CISA “Certified Information Systems Auditor” ose ekuivalent;*
- h. *Te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar Certified Incident Responder ose ekuivalent;*
- i. *Te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar CISO “Chief Information Security Officer” ose ekuivalent;*
- j. *Te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar Network Security Professional ose ekuivalent;*

**Shenim:** Nje punonjes mund te kete me shume se nje certifikate.

*Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, per te gjithë punonjesit e mesiperm pjese e stafit te punesuar nga vete OE, duhet te paraqiten certifikatat perkatese te kualifikimit si dhe operatori ekonomik duhet te vertetoje se i ka te punesuar per periudhen e dates se hapjes se tenderit.*

*Nje punonjes mund te kete nje ose disa certifikime, per te permbushur kriteret e mesiperme per certifikimet. Si permbledhje, operatori ekonomik duhet te paraqesi:*

1. *Certifikatat perkatese te kualifikimit per secilin nga specialistet e mesiperm;*
2. *Kontratën/at e punes konform legjislacionit ne fuqi të lidhura me stafin e nevojshëm.dhe CV;*
3. *Listepagesat e punonjesve dorezuara nepermjet formes elektronike ne organet kompetente apo çdo dokumentacion tjeter vertetues, per muajin e fundit”.*

Në lidhje me certifikatat e kërkuara, pranohen dhe certifikatat ekuivalente të lëshuara nga institucione certifikuese kombëtare ose ndërkombëtare.

**Sqarim:** përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, siç parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 5 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

1) Për kriterin në piken **a)** duke qene se objekti i prokurimit është Siguria Kibernetike me qëllim ruajtjen e te dhenave që gjenerohen, menaxhohen, trasmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe këmbehen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese të Oshee Group sha, është e nevojshme që OE të ketë një stafin e tij, të pakten ***te certifikuar në GDPR dhe në mbrojtjen e informacionit sensitive*** për të vënë në zbatim ekspertizën e tij profesionale për të gjitha llojet e te dhenave digjitale që qarkullojnë/ruhen në këto sisteme, duke garantuar AK-ne që të zbatohet legjislacioni vendas dhe ai i BE-se (për rregulloren GDPR etj të ngjashme) për ruajtjen sa më të plotë të konfidencialitetit të te dhenave që mund të jenë të stafit të kompanisë/AK-se apo të klienteve e furnitoreve të shumta që kanë këto sisteme në teresi. Ky certifikim është vendosur në përputhje me madhësinë e vlerës së fondit limit të vënë në dispozicion, në proporcion ndaj të gjithë profileve të eksperteve të sigurisë kibernetike dhe menaxheriale të kërkuar në këtë prokurim dhe bazuar në kompleksitetin e zbatimit të rregulloreve për rendesinë e madhe që ka konfidencialiteti i te dhenave digjitale në kuptim të legjislacionit aktual shqiptar dhe me gjere atij të BE-se;

2) Për kriterin në piken **b)** duke qene se kohezgjatja e zbatimit të kësaj kontrate është deri në 12 muaj dhe numri aktual i sistemeve dhe platformave teknologjike që ka Oshee Group sha, për të cilët do kryhet shërbimi i vlerësimit e testimeve profesionale, është relativisht i madh edhe kompleks, atëherë është e nevojshme që OE të ketë një stafin e tij, të pakten ***1(një) specialist të certifikuar PMP "Project Manager" ose ekuivalent për të vënë në zbatim ekspertizën e tij profesionale*** për të menaxhuar e koordinuar me sukses proceset e punës/shërbimeve ndërmjet stafit të eksperteve profesionale të OE fitues me stafin e AK-se. Ky certifikim është vendosur në përputhje me madhësinë e vlerës së fondit limit të vënë në dispozicion, në proporcion ndaj të gjithë profileve të eksperteve të sigurisë kibernetike dhe menaxheriale të kërkuar në këtë prokurim dhe bazuar në kompleksitetin e infrastruktures dhe platformave teknologjike ekzistuese të Oshee Group shaq e aktualisht kanë një numër tepër të madh punonjësish që do afektohen apo nderthurin punën e tyre gjatë zbatimit të kontratës në fjale;

3) Për kriterin në piken **c)** duke qene se objekti i prokurimit është Siguria Kibernetike me qëllim edhe menaxhimit e te dhenave që gjenerohen, trasmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe këmbehen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese të Oshee Group sha, meqenese një nga objektivat e prokurimit është dhe certifikimi i kompanisë sipas normës ISO 27001, është e nevojshme që OE të ketë një stafin e tij, të pakten ***1(një) specialist të certifikuar Lead Auditor ISO 27001 "Information Security Management Systems"*** për të vënë në zbatim ekspertizën e tij profesionale për të gjitha llojet e te dhenave digjitale që qarkullojnë/ruhen në këto sisteme, duke garantuar AK-ne që të kryhet vlerësimi i saktë i situatës ekzistuese dhe të implementohen, themelohen, mirëmbahet sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit sipas standartit ISO/IEC 27001 dhe atij ISO/IEC 17021, në mënyrë që të zbatohen të gjitha rregullat konform tyre. Ky certifikim është vendosur në përputhje me madhësinë e vlerës së fondit limit të vënë në dispozicion, në proporcion ndaj të gjithë profileve të eksperteve të sigurisë kibernetike



dhe menaxheriale te kerkuar ne kete prokurim dhe bazuar ne kompleksitetin e zbatimit te rregulloreve per rendesine e madhe qe ka konfidencialiteti i te dhenave digjitale ne kuptim te legjislacionit aktual shqiptar dhe me gjere atij te BE-se;

4) Për kriterin në pikën d) duke qene se OSHEE Group sh.a ka nje numer te madhe dhe kompleks te sistemeve dhe platformave teknologjike, për të cilat shërbimi i vlerësimit profesional qe do të kryhet është e nevojshme që OE të ketë të paktën **1 (një) specialist i certifikuar CISM " Certified Information Security Manager "** për të zbatuar ekspertizën e tij profesionale për të menaxhuar proceset/shërbimet e koordinuara me sukses të punës ndërmjet stafit ekspert profesional të OE fitues dhe stafit të AK-së. Ky certifikim është vendosur në përputhje me vlerën e fondit limit që do të vihet në dispozicion, në përpjesëtim me të gjitha profilet e ekspertëve të sigurisë kibernetike dhe menaxhimit të kërkuara në këtë prokurim dhe bazuar në kompleksitetin e infrastrukturës ekzistuese dhe platformave teknologjike të Oshee Group. aktualisht kanë një numër të madh punonjësish të cilët do të preken ose do të ndërhyjnë në punën e tyre gjatë Zbatimit të kontratës në fjalë.

5) Per kriterin ne piken e) duke qene se objekti i prokurimit është Siguria Kibernetike me qëllim parainformimin mbi mbrojtjen nga sulmet potenciale kibernetike nga jashte sistemeve dhe per ruajtjen e te dhenave që gjenerohen, menaxhohen, trasmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe këmbehen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, është e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten **1 (nje) specialist te certifikuar OSCP "Offensive Security Certified Professional"** për te vene ne zbatim ekspertizen e tij profesionale per te qene ne pararoje te mbrojtjes nga sulmet keqdashese/kompromentuese te te gjitha llojeve te te dhenave digjitale qe qarkullojne/ruhen ne keto sisteme, duke garantuar AK-ne qe te maksimizojë barrierat digjitale dhe te implementojë/themelojë procedurat e kunderpergjigjes ne rast situatë gjendjeje nën sulm kibernetik. Ky certifikim është vendosur ne perputhje me madhesine e vleres se fondit limit te vene ne dispozicion, ne proporcion ndaj te gjithë profileve te eksperteve te sigurise kibernetike dhe menaxheriale te kerkuar ne kete prokurim dhe bazuar ne kompleksitetin e infrastrukturës dhe platformave teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, qe aktualisht kane nje numer tepër te madh punonjësish qe do afektohen apo nderthurin punen e tyre te perditshme;

6) Per kriterin ne piken f) duke qene se objekti i prokurimit është Siguria Kibernetike me qëllim parainformimin/trainimin mbi rreziqet nga sulmet potenciale kibernetike nga jashte sistemeve dhe per ruajtjen e te dhenave që gjenerohen, menaxhohen, trasmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe këmbehen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, është e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten **1 (nje) specialist të certifikuar CISSP "Certified Information Systems Security Professional"** për të vënë ne zbatim ekspertizen e tij profesionale te posaçme, analizuese, analitike, raportuese, keshilluese, trainuese, për të qenë në pararojë të mbrojtjes nga sulmet/rreziqet keqdashese/kompromentuese te te gjitha llojeve te te dhenave digjitale qe qarkullojne/ruhen ne keto sisteme, duke garantuar AK-ne që ky i fundit, nepermjet stafit te saj TIK, pasi te trainohen me specifikat e ekspozimit digjital te sistemeve te informacionit ne pergjithesi dhe udhezimet specifike te ketij profil profesionisti, te maksimizojë efektivitetin e sigurise se ketyre sistemeve

nën infrastrukturen aktuale digjitale te AK, duke implementuar/themeluar procedurat/rregulloret/politikat e mbrojtjes/reagimeve ndaj sulmeve/infektiveve digjitale per te evituar çdo rast situatë gjendjeje në sulm kibernetik dhe per te mos nderprere asnjehere proceset e punes se perditshme. Ky çertifikim është vendosur ne perputhje me madhesine e vleres se fondit limit te vene ne dispozicion, ne proporcion ndaj te gjithë profileve te eksperteve te sigurise kibernetike te kerkuar ne kete prokurim dhe bazuar ne kompleksitetin e infrastruktures dhe platformave teknologjike ekzistuese te sistemeve te informacionit te Oshee Group sha, qe aktualisht kane nje numer tepër te madh punonjesish qe do afektohen ne rast ndodhie infektimi digjital, pasi normalisht ndërthurin punen e tyre te përditshme per realizimin e objektivave te perditshme te Oshee Group sha.

7) Për kriterin ne pikën **g**) duke qenë se objekti i prokurimit është Siguria Kibernetike me qëllim parainformimin/trainimin mbi rreziqet nga sulmet potenciale kibernetike nga jashte sistemeve, njohjen e dobësive apo prekshmëri ndaj ketyre te fundit, per ruajtjen e te dhënave që gjenerohen, menaxhohen, trasmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe këmbehen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, është e nevojshme qe OE te kete ne stafin e tij, te pakten **1 (nje) specialist të certifikuar CISA “Certified Information Systems Auditor”** për të vënë ne zbatim ekspertizen e tij profesionale te posaçme, analizuese, audituese, raportuese, keshilluese, trainuese, për të qenë në pararojë të mbrojtjes nga sulmet/rreziqet keqdashese/kompromentuese të të gjitha llojeve te te dhenave digjitale që qarkullojne/ruhen ne keto sisteme, duke garantuar AK-ne që ky i fundit, nepermjet stafit te saj TIK, pasi te trainohen me specifikat e ekspozimit digjital te sistemeve te informacionit ne pergjithesi dhe udhezimet specifike te ketij profil profesionisti, te maksimizojë efektivitetin e sigurise se ketyre sistemeve nën infrastrukturen aktuale digjitale te AK, duke implementuar/themeluar procedurat/rregulloret/politikat e mbrojtjes/reagimeve ndaj sulmeve/infektiveve digjitale per te minimizuar pikat e dobeta te ketyre sistemeve dhe rrejdhimisht duke evituar çdo rast situatë gjendjeje në sulm kibernetik dhe per te mos nderprere asnjehere proceset e punes se perditshme. Ky çertifikim është vendosur ne perputhje me madhesine e vleres se fondit limit te vene ne dispozicion, ne proporcion ndaj te gjithë profileve te eksperteve te sigurise kibernetike te kerkuar ne kete prokurim dhe bazuar ne kompleksitetin e infrastruktures dhe platformave teknologjike ekzistuese te sistemeve te informacionit te Oshee Group sha, qe aktualisht kane nje numer tepër te madh punonjesish që do afektohen në rast ndodhie infektimi digjital, pasi normalisht ndërthurin punën e tyre të përditshme për realizimin e objektivave të perditshme të Oshee Group sha.

8) Per kriterin ne piken **h**) duke qene se objekti i prokurimit është Siguria Kibernetike me qëllim parainformimin/trainimin mbi rreziqet nga sulmet potenciale kibernetike nga jashte sistemeve dhe per ruajtjen e te dhenave që gjenerohen, menaxhohen, trasmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe këmbehen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, është e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten **1 (nje) specialist te certifikuar CIR “Certified Incident Responder”** për të vënë ne zbatim ekspertizen e tij profesionale analizuese, analitike, raportuese, trainuese, për të qenë në pararojë të mbrojtjes nga

sulmet/rreziqet keqdashese/kompromentuese te te gjitha llojeve te te dhenave digjitale qe qarkullojne/ruhen ne keto sisteme, duke garantuar AK-ne qe kjo e fundit, nepermjet stafit te saj TIK, pasi te trainohen me metodikat dhe udhezimet specifike te ketij profil profesionisti, te maksimizoje efektshmerine e kunderpergjigjes duke implementuar/themeluar procedurat/rregulloret/politikat e kunderpergjigjes ne rast situatë gjendjeje nën sulm kibernetik. Ky certifikim është vendosur ne perputhje me madhesine e vleres se fondit limit te vene ne dispozicion, ne proporcion ndaj te gjithe profileve te eksperteve te sigurise kibernetike dhe menaxheriale te kerkuar ne kete prokurim dhe bazuar ne kompleksitetin e infrastruktures dhe platformave teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, qe aktualisht kane nje numer tepër te madh punonjesish qe do afektohen ne rast ndodhie incidenti pasi normalisht ndërthurin punen e tyre te përditshme per realizimin e objektivave te perditshme te Oshee Group sha;

9) Për kriterin në pikën j) duke qenë se objekti i prokurimit është Siguria Kibernetike për qëllimin e parainformimit mbi rreziqet e sulmeve të mundshme kibernetike nga jashtë sistemeve dhe për ruajtjen e të dhënave që gjenerohen, menaxhohen, transmetohen, e koordinuar/sinkronizuar dhe shkëmbyer nga infrastruktura ekzistuese dhe platformat teknologjike të Oshee Group sha, është e nevojshme që OE të ketë të paktën 1 (një) specialist të certifikuar " *Network Security Professional*" për të zbatuar ekspertizën e tij profesionale, analiza, raportimi, trajnimi, për të qenë në ballë të mbrojtjes kundër sulme keqdashëse/kompromentuese/rreziqe të të gjitha llojeve të të dhënave dixhitale që qarkullojnë/ruhen në këto sisteme, duke garantuar AK - në që kjo e fundit, nëpërmjet stafit të saj TIK, pasi të jetë trajnuar me specifikat e ekspozimit dixhital në rrjet dhe udhëzimet specifike të ky profil profesional, maksimizon efektivitetin e sigurisë së sistemeve nën infrastrukturën aktuale dixhitale duke zbatuar procedura/rregullore/politika të vendosura të mbrojtjes/reagimeve ndaj sulmeve për të shmangur çdo situatë nën sulm kibernetik dhe për të mos ndërprerë kurrë proceset e përditshme të punës. Ky certifikim vendoset në përputhje me madhësinë e vlerës së fondit limit. në dispozicion, në proporcion me të gjitha profilet e ekspertëve të sigurisë kibernetike që kërkohen në këtë prokurim, pasi infrastruktura dhe numri i platformave teknologjike e administrative te AK është i konsiderueshem, kompleks, numri i punonjesve operues dhe nderveprues është tepër i larte dhe rendesise se harmonizimit dhe objektivave te konformitetit drejt legjislacionit te vendeve te BE-se;

10) Per kriterin ne piken i) duke qene se objekti i prokurimit është Siguria Kibernetike me qëllim parainformimin/trainimin mbi rreziqet nga sulmet potenciale kibernetike nga jashte sistemeve dhe per ruajtjen e te dhenave që gjenerohen, menaxhohen, trasmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe këmbehen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, është e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten 1 (nje) *specialist të certifikuar CISO "Chief Information Security Officer"* për të vënë ne zbatim ekspertizen e tij profesionale analizuese, analitike, raportuese, trainuese, për të qenë në pararojë të mbrojtjes nga sulmet/rreziqet keqdashese/kompromentuese te te gjitha llojeve te te dhenave digjitale qe qarkullojne/ruhen ne keto sisteme, duke garantuar AK-ne që kjo e fundit, nepermjet stafit te saj TIK, pasi te trainohen me specifikat e testeve te penetrimin digjital dhe udhezimet

specifike te ketij profil profesionisti, te maksimizoje efektivitetin e sigurise se sistemeve nen infrastrukturen aktuale digjitale te AK duke implementuar/themeluar procedurat/rregulloret/politikat e mbrojtjes ndaj penetrimeve per te evituar çdo rast situate gjendjeje nën sulm kibernetik. Ky çertifikim është vendosur ne perputhje me madhesine e vleres se fondit limit te vene ne dispozicion, ne proporcion ndaj te gjithë profileve te eksperteve te sigurise kibernetike te kerkuar ne kete prokurim dhe bazuar ne kompleksitetin e infrastruktures dhe platformave teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, qe aktualisht kane nje numer tepër te madh punonjeshish qe do afektohen ne rast ndodhie penetrimi, pasi normalisht ndërthurin punen e tyre te përditshme per realizimin e objektivave te perditshme te Oshee Group sha;

**Qëllimi dhe objektivi final i ketyre kritereve është mosnderprerja e shërbimeve shume te rendesishme te ofruara perdite nga punonjesit dhe sistemet teknologjike te Oshee Group sha, sigurimi i vijimësise se punës, mos rrezikimi i ekspozimit të të dhënave konfidenciale që përmbajnë/grumbullojnë e menaxhojne këto sisteme dhe sigurisht minimizimi maksimal i humbjeve të pallogaritshme financiare zinxhir që do shkaktoheshin në rast ndërprerjeje të proceseve të përditshme te punës si rezultat i mos-kryerjes së këtij prokurimi, ne kuadër të progresit te vazhdueshëm e të pandalshem teknologjik faktik të platformave ekzistuese dhe atyre që do vijnë në të ardhmen e afërt për Oshee Group sha.**

Listpagesat apo çdo dokument tjetër ekuivalent vërtetues i listës së personelit, e të paktën muajit të fundit nga data e hapjes se ofertës, vërtetimi tatimor apo ekuivalent për numrin total të personelit të operatorit ekonomik, kontratat e punes akoma të vlefshme me stafin përkares teknik, janë grupi i dokumentave normale dhe lehtësisht të gjetshëm për tu paraqitur paraprakisht nga OE bashkë me formularin e ofertës tekniko-ekonomike dhe vetedeklarimet e tjera, në mënyrë që të bëhet një vlerësim sa më i drejtë dhe profesional nga KVO.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë teknologjitë ekzistuese dhe nevojat për funksionalitet, zgjerim në cilësi e performancë të disa prej sistemeve kryesore në zotërim nga Autoriteti Kontraktor, për blerjet e reja cilësore qe zgjerojnë ato ekzistuese dhe upgrade (përmirësim) te sistemeve ekzistuese sipas objektit të procedurës se prokurimit, duke përlllogaritur mënyrën e ofrimit te produkteve dhe shërbimeve e garancive të suportit, karakteristikat e duhura, standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke ruajtur garancitë përkatëse të këtyre sistemeve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta për kualifikim janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër të posaçëm nga titullari, duke marrë në konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, për

produktet/shërbimet/garancitë objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Termet e References/Specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta për kualifikim janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdher të posaçëm nga titullari, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimet objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

### **Njesia e Prokurimit**